

VENDIM
Nr. 24, datë 20.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ë ndryshuar; të kreut I, të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, ë ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH’”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 24 , datë 20.8.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje pune dhe personale nr. 2366, “Kritiku”, në ngarkim të Xh. M., me 114 (njëqind e katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, procesverbal asgjësimi nr. 18, datë 26.5.1982, në ngarkim të L. Ç., me 1 (një) fletë. Dokumenti daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, fashikull nr. 2803, në ngarkim të R. A., me 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1946–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, dosje formulare nr. 6502, në ngarkim të B. B., me 3 volume, në total me 780 (shtatëqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje agjenturore nr. 1735, “Paraziti” në ngarkim të F. D., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje formulare nr. 1731, në ngarkim të F. D., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje pune nr. 899, “Rozmaria” në ngarkim të E. K., me 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje pune dhe personale nr. 456, “Benzinati” në ngarkim të Z. H., me 282 (dyqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

· Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.
3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t'i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.
4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula